

Të paktën 10 të vrarë nga të shtënat në një shkollë në Austri

VJEN, 10 QERSHOR - Të paktën dhjetë njerëz, përfshirë shtatë nxënës, janë vrarë të martën në një sulm të dyshuar me armë në një shkollë në qytetin Grac, në jug të Austrisë. Kancelari austriak Christian Stocker tha se në shtet do të shpallen tri ditë zie për shkak të ngjarjes në Grac. Kryetarja e qytetit të Gracit, Elke Kahr, tha se sulmuesi i dyshuar është vrarë gjithashtu. Ajo e përshkroi sulmin si “tragjedi e tmerrshme”. Khar tha se shumë njerëz të tjerë janë dërguar në spitale për shkak të plagëve. Policia austriake tha se beson se sulmuesi veproi i vetëm. Autoritetet ende nuk kanë

zbuluar ndonjë motiv të mundshëm për sulmin. Po ashtu, zyrtarët nuk kanë dhënë informacione për të dyshuarin apo për viktimat. Edhe Forcat Speciale janë dërguar në gjimnazin BORG Dreierschützengasse pas një telefonate në orën 10:00 të mëngjesit. Rreth një orë më vonë, policia njoftoi në rrjetin social X se të gjithë janë evakuuar nga shkolla dhe janë dërguar në vend të sigurt. Policia shtoi se situata është “nën kontroll” dhe se nuk ka më rrezik. Ngjarja në Grac është dënuar nga udhëheqësit kryesorë evropianë. Shefja e Komisionit Evropian,

Ursula von der Leyen, tha se “shkollat janë simbol i rinisë, shpresës dhe të ardhmes”, duke shtuar se është e rëndë kur “shkollat bëhen vende të vdekjes dhe dhunës”. Presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier dhe kancelari Friedrich Merz, po ashtu, kanë shprehur ngushëllime për familjarët e viktimave. Ndërkaq, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në reagimin e saj tha se shkollat duhet të jenë vend ku “fëmijët ëndërrojnë, mësojnë e rriten, e jo vend i dhunës dhe terrorit”. Graci, qyteti i dytë më i madh i Austrisë, ndodhet në juglindje të vendit dhe ka rreth 300 000 banorë.



Serbia merr gati dy miliardë euro hua për t'i paguar avionët Rafale



Beograd, 10 qershor - Ministri i Financave i Serbisë, Sinisha Mali, tha se vendi i tij do të marrë hua rreth 1.9 miliard euro nga bankat e huaja për ta bërë pagesën e plotë të 12 avionëve luftarakë, Rafale, të blerë nga Franca. Duke folur në një seancë të Kuvendit të Serbisë, agjenda e së cilës përfshinte konfirmimin e marrëveshjes së kredisë, Mali tha se dy paradhëniet e para për prokurimin tashmë i janë paguar palës franceze. Ai tha se Serbia do ta marrë avionin e parë Rafale në fillim të vitit 2028 dhe, më pas, çdo muaj nga një, raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë. “Me 12 avionë

luftarakë shumëfunksionalë, ne do ta përmirësojmë aviacionin dhe ushtrinë”, tha Mali. Qeveria e Serbisë, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, arriti marrëveshje për blerjen e këtyre avionëve me kompaninë franceze “Dassault Aviation” në gusht të vitit 2024. Blerja e 12 avionëve francezë dhe mjeteve të tjera shoqëruese i kushtoi 2.7 miliardë euro. Prej kësaj shume, 823.5 milionë euro ose e gjithë paradhënia është paguar. Për borxhin e ri, huadhënëse fillestare do të jenë disa banka dhe institucione kreditore franceze. Blerja e këtyre avionëve u dakordua gjatë vizitës së

presidentit francez Emmanuel Macron, në Serbi, në gusht të vitit 2024. Me këtë blerje, Serbia për herë të parë futi avionë perëndimorë në aviacionin e saj ushtarak. Serbia bashkëpunon me anëtarët e NATO-s përmes Programit të Partneritetit për Paqe që nga viti 2006, por zyrtarët në Beograd këmbëngulin se vendi i tyre është ushtarakisht neutral. Në prill të vitit 2024, kur po zhvilloheshin negociatat me Francën për blerjen e avionëve Rafale, Ministria serbe e Mbrojtjes tha se kjo nuk nënkupton ndonjë ndryshim në orientimin ushtarak të vendit.

Trumpi urdhëron dislokimin e marinsave dhe trupave shtesë të Gardës Kombëtare në Los Anxhelos

UASHINGTON, 10 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka urdhëruar dërgimin e 700 marinsave amerikanë dhe 2 000 trupave shtesë të Gardës Kombëtare në Los Anxhelos, duke u zotuar se ata që protestojnë kundër arrestimit të imigrantëve, do të “goditen më fort” se kurrë më parë. Dërgimi i mijëra trupave dhe qindra marinsave të martën po ndodh në ditën e katërt të protestave të mëdhave në rrugët e Los Anxhelosit, të nxitura nga arrestimi i dhjetëra imigrantëve në një qytet me një popullsi të madhe të lindur jashtë vendit dhe me prejardhje latine. Guvernatori i Kalifornisë, Gavin Newsom, e kritikoi ashpër këtë vendim të Trumpit, duke e quajtur të pamatur si dhe “mungesë respekti ndaj trupave tona”. “Kjo nuk ka të bëjë me sigurinë publike”, shkroi Newsom në X. “Ka të bëjë me ushqimin e egos së

rrezikshme të një presidenti”. Dislokimi ndodhi pas protestave të së dielës, kur demonstruesit dolën në rrugë në qendër të Los Anxhelosit, duke djegur vetura dhe plaçkitur dyqane. Forcat e rendit u detyruan të përdorin gaz lotsjellës dhe plumba gome ndaj protestuesve. Ndërkohë, protestat e së hënës ishin kryesisht paqësore, pas trazirave gjatë fundjavës që pasuan arrestimin e dhjetëra personave që autoritetet i përshkruan si imigrantë të paligjshëm dhe anëtarë bandash. Në qytetin Santa Ana, rreth 50 kilometra në jugperëndim të Los Anxhelosit, forcat e rendit përdorën gaz lotsjellës ndaj protestuesve që brohorisnin kundër Agjencisë për Imigracion dhe Dogana (ICE) mbrëmjen e së hënës. Duke folur në Uashington, Trumpi i quajti protestuesit “nxitës profesionistë dhe kryengritës”.



Trumpi shkroi në rrjetet sociale se protestuesit kishin pështyrë trupat, dhe nëse vazhdojnë ta bëjnë këtë, “ju premtoj se do të goditen më fort se kurrë më parë”. Pavarësisht prej veprimeve të izoluara të dhunës, zyrtarët dhe forcat vendore të rendit theksuan

se shumica e protestuesve gjatë fundjavës kishin qenë paqësorë. Shkollat në gjithë Los Anxhelosin funksiononin normalisht të hënën, ndërsa jeta në qytet dukej kryesisht e pandryshuar. Në kontrast me përshkrimin e Trumpit, kryetarja e Los

Anxhelosit, Karen Bass, tha: “Kjo nuk është trazirë qytetare në shkallë të gjerë. Është e kufizuar në disa rrugë”. Shefi i Policisë së Los Anxhelosit, Jim McDonnell, tha se autoritetet vendore janë në gjendje ta kontrollojnë qytetin. “Futja e personelit ushtarak federal pa koordinim të drejtpërdrejtë krijon sfida logjistike dhe rrezik për konfuzion gjatë incidenteve kritike”, tha ai për gazetarët. Të paktën 56 njerëz u arrestuan gjatë dy ditëve të fundit dhe pesë oficerë pësuan lëndime të lehta, thanë zyrtarët e Policisë së Los Anxhelosit, ndërsa rreth 60 persona u arrestuan në protestat në San Francisko. Protestuesit u përleshën me policinë edhe në Nju-Jork Siti dhe në Austin, Teksas, të hënën. Kjo është hera e parë në dekada që Garda Kombëtare shtetërore aktivizohet pa kërkesën e guvernatorit.

SHËNOHET 147-VJETORI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRIZREN, 10 QERSHOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në shënimin e 147-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i cili u mbajt në hapësirat e Lidhjes në këtë qytet. “Vit pas viti, në çdo përvjetor, për çdo 10 qershor, ky log ku jemi mbledhur sot bashkë, na ka bashkuar për ta përkujtuar Lidhjen dhe për t’u rigjallëruar nëpërmjet trashëgimisë së saj. Ne nuk e kemi ndryshuar kurrë thirrjen e kësaj ngjarje të përvitshme, e cila thërret: Lidhja është gjallë”, tha kryeministri Kurti.

Ai shtoi se Organizata “Lidhja Shqiptare” me seli në Prizren është pika më kulmore e Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. “Ajo është Rilindja Kombëtare në akt politik. Lidhja Shqiptare, e cila u themelua në Prizren, në Xhaminë e Bajrakut më 10 qershor 1878, paraqet një lloj nyje tek e cila përbashkohen të gjitha çështjet kyçe dhe temat qendrore të historisë moderne

të shqiptarëve dhe kjo, si në kontekstin e brendshëm shqiptar, ashtu edhe në gjendjen e shoqërisë botërore të asaj kohe”, tha Kurti.

Ndër të tjera, kryeministri përmendi faktin se Lidhja Shqiptare u formua si organizatë politike, e cila do ta artikulonte vullnetin politik të të gjithë shqiptarëve karshi vendimeve të Kongresit përkatësisht Traktatit të Berlinit. Themelimi i Lidhjes do t’i jepte zë mendimit politik të Sami Frashërit dhe të Pashko Vasës, dy emra të mirënjohur edhe brenda vetë sferës publike osmane.

Kryeministri theksoi se për herë të parë në një interval disashekullorë historikë, Lidhja po themelonte një kahe të re, atë të idesë së bashkimit në ide e përfaqësim e përpjekje të shqiptarëve. “Ajo po bashkonte rreth një projekti të vetëm politik kombëtar përtej dallimeve fetare, krahinore e fisnore, numrin maksimal të shqiptarëve në të katër vilajetet e banuara me shumicë shqiptare. Qëllimi ishte një



vilajet shqiptar i mëvetësishëm si njësi unike në hapësirën e Rumelisë, siç quheshin territoret evropiane të Perandorisë Osmane atëbotë. Lidhja i dha pozicion të qartë politik shqiptarëve sa i takon premisë tashmë gjerësisht evropiane të rezultimit të çdo kombi të vërtetë me një shtet për vete”, tha kryeministri.

Në shënim të kësaj ngjarje të rëndësishme kryeministri theksoi se me Lidhjen e Prizrenit shqiptarët po shpreheshin në mënyrë unike mbi çfarë ishin ata vetë dhe çka ishte realiteti politik ndërkombëtar. Pavarësisht shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si organizatë, ajo ka mbetur e gjallë si shembull qëndrimi dhe misioni në historinë e përpjekjes së shqiptarëve për jetësimin e

vullnetit të tyre legjitim politik, si një projekt afirmativ dhe për paqe.

Në 147-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryeministri tha se Lidhja dhe mendimtarët e Rilindjes e thanë qartë se një Ballkan i qetë dhe me të ardhme premtuese është Ballkani ku shqiptarët respektohen në gjuhën, numrin dhe territorin e tyre. Ata kërkonin atë që u takonte, dhe mëvetësinë nuk e donin për të dominuar të tjerët, por për të qenë të barabartë me të tjerët. “Le të mendojmë sa herë që përmendim Lidhjen, edhe Rilindjen, këtë lëvizje të madhe të mendimit dhe të gjuhës të përbërë nga njerëz të një dije të lartë e të shquar, të vendosur më shumë se kurrë përpara një të shkuare të pashtjelluar kombëtare dhe një horizonti të

ndërlikuar ndërkombëtar. Andaj, i shkon një nderim monumental të tërë atyre njerëzve që e ideuan Lidhjen dhe që e themeluan atë në qytetin e bukur të Prizrenit”, përfundoi fjalën e tij kryeministri Kurti.

Ndërkaq presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se erdhi sot në këtë ditë me një grup nxënësish të shkollës “Lidhja e Prizrenit” në Tiranë. “Përmes kujtimit të ngjarjeve të mëdha historike ne u japim brezave shembuj dhe vlera. U mësojmë se liria nuk është e dhënë, por e fituar, se atdheu nuk është vetëm vendi ku jetojmë, por pjesë e natyrshme e identitetit tonë, se historia jonë nuk është përrallë nga e kaluara, por trashëgimi solemne që na detyron”, ka thënë Begaj.

ME FTESË TË QEVERISË SË JAPONISË, OSMANI KA UDHËTUAR PËR VIZITË BILATERALE ZYRTARE

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar zyrtarisht për në Japoni, ku do të zhvillojë një sërë takimesh bilaterale. Gjatë vizitës zyrtare në Tokio, presidentja Osmani do të pritë në takim nga Lartmadhëria e Tij, Perandori i Japonisë. Presidentja do të ketë takim bilateral edhe me kryeministrin e Japonisë, Shigeru Ishiba, ku do të diskutohet fuqizimi i marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Japonisë. Përgjatë vizitës zyrtare, presidentja do të ketë takim edhe me kryetarin e parlamentit, Fukushima Nukaga. Përveç vizitës në Tokio, gjatë qëndrimit në Japoni presidentja Osmani do të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare për shënimin e Ditës së Kosovës në Ekspozitën Botërore Expo 2025 në Osaka. Në hapjen zyrtare të Ditës së

Kosovës në Osaka, presidentja Osmani do të pritë nga ministri Naoki Okada, përgjegjës për Expo Osaka 2025. Ajo do t’u drejtohet të pranishmëve me fjalimin kryesor në emër të Republikës së Kosovës si dhe do ta vizitojë Pavijonin e Kosovës. Ceremonia e hapjes zyrtare të Ditës së Kosovës do të përcillet me një koncert të veçantë nga Filarmonia e Kosovës. Në kuadër të vizitës, Osmani do ta udhëheqë takimin biznesor në Tokio së bashku me një delegacion të përbërë nga përfaqësues të bizneseve nga Kosova, si dhe në prani të bizneseve nga Japonia. Ky takim synon promovimin e mundësive për investime japoneze në Kosovë dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik dypalësh.

Gjithashtu, presidentja Osmani do të takohet me Tanaka Akihiko, kryetar i Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar



(JICA), për të diskutuar rreth mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm zhvillimor me Japoninë. Si pjesë e agjendës së saj zyrtare

në Tokio, presidentja Osmani do të ketë një diskutim me studentë të Sophia University si dhe një sërë aktiviteteve të tjera

që kanë për synim afirmimin dhe thellimin e mëtejshëm të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Japonisë.



“LIRIA KA EMËR” NUMËRON SHKELJET E GJYKATËS SPECIALE NDAJ KRERËVE TË UÇK-së, PARALAJMËROHEN EDHE PROTESTA

Platforma “Liria ka emër”, në një konferencë për medie të martën, është shprehur e shqetësuar për ecurinë e procesit gjyqësor ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Në vlerësimin e Ismail Tashollit procesi gjyqësor në Speciale ka devijuar nga rruga e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Sipas tij, procesi që është zhvilluar ka qenë jashtë standardeve evropiane. Tasholli ka paralajmëruar se në të ardhmen, nëse nuk ka ndryshime, mbetet i hapur optionsi për protesta. Ndërkaq profesori i së Drejtës Kushtetuese, njëherësh deputet, Përparim Gruda, ka numëruar shkeljet në këtë proces, duke theksuar se paraburgimi i gjatë i Hashim Thaçit dhe të tjerëve përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe të Kushtetutës së Kosovës

veprim të standardeve evropiane. Procesi që është zhvilluar ka qenë jashtë standardeve evropiane. Sot kur procesi po shkon drejt përfundimit jemi të bindur që këto shkelje duhet të evidentohen qartë dhe të ngrihet zëri i padrejtësisë. Të gjitha këto shkelje tregojnë që procesi ka devijuar. Kërkojmë të rishqyrtohen proceset dhe të garantohet që të veprohet në bazë të drejtësisë e jo në bazë të paragjykitimit. U bëjmë

thirrje shteteve financuese që të marrin përgjegjësinë institucionale e morale për të garantuar që puna e Gjykatës të jetë në përputhje me parimet themelore të drejtësisë, e jo të ndikohet nga interesat apo agenda politike. Kjo nuk është përpjekje për të ndërhyrë në drejtësi, por kërkesë që drejtësia të zbatohet në përputhje me parimet e standardet evropiane”, ka thënë Tasholli. Ai ka paralajmëruar se në të

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Platforma “Liria ka emër” ka mbajtur një konferencë për medie të martën, në të cilën ka shprehur shqetësimin për shkeljet e të drejtave në gjykimin e drejtuesve të UÇK-së në Gjykatën Speciale në Hagë.

Platforma “Liria ka emër” ka theksuar se është jetike për të rikujtuar se drejtësia ndërkombëtare nuk bën të jetë selektive dhe as të shërbejë si instrument i presioneve politike. Përkundrazi, sipas saj, ajo duhet të veprojë me integritet të plotë, në respekt të ligjit, të drejtave themelore dhe të dinjitetit njerëzor.

“Liria ka emër” ka potencuar se shkeljet në këtë proces nuk

janë vetëm çështje procedurale, por çështje të rendit demokratik dhe të sovranitetit juridik të Kosovës. Kërkesa “Liria ka emër” është e qartë: drejtësi pa standarde të dyfishta, barazi para ligjit dhe garantim i një procesi që reflekton parimet mbi të cilat është ndërtuar vetë rendi demokratik evropian.

Ismail Tasholli nga platforma “Liria ka emër” ka thënë se procesi gjyqësor ka devijuar nga standardet evropiane dhe bëri thirrje për rishqyrtim të procedurave, duke kërkuar drejtësi të paanshme dhe jo të bazuar në paragjykitime. “Jemi këtu për të shprehur shqetësimin tonë në lidhje me shkeljet e drejtave në Gjykatën Speciale. Kosova ka mbështetur themelimin e Gjykatës Speciale me besimin e saj që do të përcillen me



OVLUÇK-ja I KËRKON PRESIDENTES OSMANI SQARIME PËR ZGJATJEN E MANDATIT TË EULEX-IT DHE DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

Prishtinë, 10 qershor - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) i është drejtuar me një letër presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, duke kërkuar sqarime lidhur me zgjatjen e mandatit të Misionit të EULEX-it dhe të Dhomave të Specializuara në Hagë. Në letrën zyrtare, OVLUÇK-ja kërkon të mësojë nëse është marrë ndonjë vendim final për zgjatjen e mandatit për periudhën 2025-2027, siç kanë raportuar mediet evropiane dhe vendore.

Po ashtu, organizata është interesuar të dijë nëse ka pasur shkëmbim të ri letrash në mes të presidentes Osmani dhe përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, lidhur me këtë çështje. "Jemi të vetëdijshëm se në të kaluarën vendime të tilla janë formalizuar përmes



shkëmbimit zyrtar të letrave ndërmjet zonjës Osmani dhe përfaqësuesit të lartë të BE-së", thuhet në letër.

OVLUÇK-ja thekson se është drejtpërdrejt e interesuar në këtë proces, pasi shumë nga bashkëluftëtarët e saj ndodhen aktualisht në paraburgim në

Dhomat e Specializuara në Hagë. "Duke qenë se shumë nga bashkëluftëtarët tanë ndodhen aktualisht në paraburgim në Dhomat e Specializuara në Hagë, ne si organizatë jemi drejtpërdrejt palë e interesuar në këtë proces", përfundon letra.

EULEX-i dhe Dhoma e Specializuar vazhdojnë të jenë çështje me ndikim të madh politik dhe juridik në Kosovë, dhe vendimet për mandatin e tyre shpeshherë kanë pasojë të gjera në skenën politike dhe shoqërore. Për këtë temë ka shkruar një

ditë më parë edhe deputeti i PDK-së, Artan Behrami. "Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, përmes shkëmbimit të letrave me BE-në ka vazhduar mandatin e EULEX-it, rrjedhimisht edhe të Gjykatës Speciale në Kosovë. Këtë e ka bërë në mënyrë tinëzare, pa debat publik, në mënyrë të fshehtë. Ajo po e fsheh përmbajtjen. Vazhdimi i misionit të EULEX-it, pas padrejtësive në Gjykatën Speciale e pa debat, është skandaloz. Presidentja është dashur të negociojë vazhdimin e mandatit, të paktën me kusht që EULEX të marrë përsipër garancitë që kërkon Gjykata Speciale për lirim nga paraburgimi dhe mbrojtje në liri të krerëve të UÇK-së. EULEX është mekanizmi kryesor i Gjykatës Speciale në Kosovë!", ka shkruar Behrami në "Facebook".

VUKOTIQI DËNOHET 15 VJET BURGIM PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar 15 vjet burgim Zoran Vukotiqin për krime lufte në Kosovë. Aktgjykimi dënues u shpall ndaj Vukotiqit, pasi gjykata e gjeti fajtor për vrasjen e 13-vjeçarit B. M., raporton "Betimi për Drejtësi".

Sipas aktakuzës të ngritur në qershor të vitit 2023, Vukotiqi akuzohej se më 18 prill të vitit 1999, në afërsi të varrezave të qytetit të Vushtrisë, në bashkëkryerje me persona të pidentifikuar, si rezervist i policisë serbe, kishte vepruar në kundërshtim me normat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi gjatë konfliktit në Kosovë. Në aktakuzë thuhej se ai në bashkëkryerje ka vrrarë 13-

vjeçarin B. M. të kombësisë shqiptare.

Viktima së bashku me djalin e xhaxhait kishin qenë duke ngarë një biçikletë, kur Vukotiqi së bashku me policë të tjerë të armatosur i kishin hasur fëmijët. I pandehuri, sipas aktakuzës, nga largësia prej 30 metrash kishte gjuajtur me armë zjarri drejt fëmijëve, duke qëlluar në gjoks viktimën B. M., i cili kishte vdekur menjëherë. Fëmija tjetër kishte arritur t'u shpëtojë të shtënave dhe ishte fshehur pas një muri.

Prokuroria Speciale kishte ngritur katër aktakuza për krime lufte ndaj popullatës civile gjatë viteve 1998-1999 ndaj Vukotiqit, por me propozimin e avokatit të tij, ato u bashkuan në një

çështje më 2024.

Për pikat e tjera të aktakuzës, pas bashkimit të çështjes, Gjykata tha se nuk ka gjetur prova ndaj Vukotiqit dhe ai është liruar nga ato akuza. Ndaj ish-rezervistit të policisë serbe, Zoran Vukotiq, më herët është shqiptuar edhe një aktgjykim dënues. Ai më 2021 ishte dënuar me dhjetë vjet burgim për veprën penale të dhunës seksuale gjatë luftës. Ky rast ishte kthyer në rigjykim, por më 2022 ishte rikonfirmuar ndaj tij. Më pas, më 2023, Apeli ia rriti dënimin në 13 vjet burgim. Në këtë aktakuzë thuhej se Vukotiqi si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë "kishte



marrë pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, në kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj tyre si dhe me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore,

kishte kryer dhunim seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar".

Ky ishte rasti i parë i dënuar për një krim të tillë nga gjykatat e Kosovës.

ardhmen, nëse nuk ka ndryshime, mbetet i hapur opsioni për protesta. "Zakonisht ne kemi mekanizma qytetar për t'iu përgjigjur secilës padrejtësi, opSION është edhe protesta. Secila mundësi është e hapur. Të shohim nëse diçka po ndërron për mirë, krejt rruga është e gabuar. Shpresojmë që nuk do të vazhdojë të ndodhin këto shkelje, opsionet e një përgjigje qytetare janë të hapura", ka deklaruar Tasholli. Profesori i së Drejtës Kushtetuese, njëherësh

deputet, Përparim Gruda, ka numëruar shkeljet në këtë proces. Ai ka thënë se paraburgimi i gjatë i Hashim Thaçit dhe të tjerëve përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe të Kushtetutës së Kosovës. Gruda ka theksuar se marrja e provave nga Serbia e vendos mbrojtjen në pozitë të pabarabartë dhe ka kërkuar ndaljen e kësaj praktike. "Gjykata Speciale, që akuzon Thaçin dhe të tjerët, është themeluar mbi raportin e Dick Martyt për Shtëpinë e Verdhë dhe, mbi këtë fakt, është

ndërtuar Gjykata. Kur është publikuar aktakuza me redaktimet që dihen, sot në fund të procesit nuk ekziston asnjë fjali për Shtëpinë e Verdhë. E dyta, ju e dini që Hashim Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi janë për më shumë se 4 vjet në paraburgim, nuk janë në burg. Prezumohen të pafajshëm ligjrisht. Kjo është shkelje e standardeve për të drejtat e njeriut, shkelje e Kushtetutës, shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E pabesueshme që një gjykatë

në zemër të Evropës mban të akuzuarit 4 vjet në paraburgim. Shkelja e tretë është marrja e provave përmes Serbisë. Serbia është vend armiqësor ndaj Kosovës, dhe fakti që Prokuroria ka akses për të marrë prova, e mbrojtja nuk ka, sepse nuk ka kuptim, i vë në pozicion të pabarabartë. E katërta, në rastin e Salih Mustafës, Dhoma Kushtetuese ka refuzuar zbatimin e parimit lex mitior, zbatimimi i ligjit më të favorshëm. Ky parim është pjesë e Kushtetutës dhe Konventës për të Drejtat e

Njeriut. Kjo është bërë në emër të autonomisë kundrejt rendit juridik", ka thënë Gruda, duke shtuar se është e rëndësishme që shoqëria e Kosovës, institucionet dhe kushdo, të përmbahet nga ndërhyrja në punën e Gjykatës Speciale. "E respektoj këtë parim të shenjtë, që gjykatat duhet të jenë të lira dhe të pavarura. Duhet të ruhet pavarësia e gjykatës, por asnjë shoqëri evropiane e lirë nuk mohohet nga debati", ka përfunduar Përparim Gruda.

Delegacioni i FSK-së viziton shkollën e nënoficerëve në Gjermani

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Delegacioni i FSK-së nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) ka vizituar Shkollën e Nënoficerëve të Forcave Tokësore të Ushtrisë Gjermane në Delitzsch të Gjermanisë. Vizita u realizua në kuadër të planit bilateral ndërmjet FSK-së dhe

ushtrisë gjermane. Fillimisht pjesëtarët e KDS-së u pritën nga komandanti i shkollës, kolonel Schnebelt dhe stafi i tij. Ata u njoftuan nga afër me sistemin e shkollimit të NOF gjerman, metodikën e ligjëratave si dhe shikuan nga afër trajnimet në orët praktike që u

mbajtën. Vizita kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave si dhe krijimin dhe përforcimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave. Në përfundim të vizitës palët pjesëmarrëse u zotuan për thellim të bashkëpunimit në të ardhmen.



PËRURORHET NJË ÇERDHE E RE NË SKENDERAJ

SKENDERAJ, 10 QERSHOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka marrë pjesë në përrurimin e çerdhes më të re në komunën e Skenderajt, bashkë me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav dhe kryetarin e komunës së Skenderajt, Fadil Nura. Kryeministri tha se kjo çerdhe e re nuk është vetëm hap përpara në zhvillimin e shoqërisë, por tregues i fuqishëm që fëmija është kryefjala e politikave publike dhe veprimeve konkrete tona të përbashkëta. Ai shtoi se investimet tona në komunën e Skenderajt gjatë këtij mandati



kapin totalin prej 3,2 milionë eurosh, nga të cilat 2,1 milionë euro është shuma e punimeve

të finalizuara deri tani, ndërkaq rreth 66 mijë euro inventar nga Ministria e

Arsimit janë vetëm fillimi i mbështetjes sonë për këtë fole të re për brezin e ri. Duke shprehur mirënjohjen ndaj Bashkimit Evropian për mbështetjen, kryeministri tha se: “Kjo çerdhe është një shembull i mirë se si investimet e Bashkimit Evropian po realizohen në kohën dhe në vendin e duhur. Me ndihmën e IPA fondeve, 1.2 milionë euro, pra të instrumentit të paraanëtarësimit, ky projekt është përfunduar dhe do të shërbejë për fëmijët më të vegjël. Natyrisht, me çdo sukses të radhës po e sjellim Kosovën një hap më afër Bashkimit Evropian në aspektin ekonomik e arsimor, intelektual e shoqëror”.

Nga ana e saj, ministria Nagavci tha se kjo është një nga gjashtë çerdhet që po ndërtohet me fondet IPA të Bashkimit Evropian dhe sipërfaqja e saj me 1 600 metra katrorë dhe hapësira përcjellëse mbi 800 metra katrorë, do të ofrojë terren për aktivitete të shumta edukativo-arsimore. Ndërkaq ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, theksoi se çerdhja është më shumë sesa një ndërtesë: është simbol i progresit, partneritetit dhe shpresës për të ardhmen. “Bashkimi Evropian ka angazhim të fuqishëm dhe jetëgjatë në ndërtimin e infrastrukturave jetike publike në Kosovë”, shtoi ai.

KOSOVA PËRURON OBJEKTIN E RI TË NJË STACIONI POLICOR AFËR KUFIRIT ME SERBINË

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Autoritetet e Kosovës kanë përruruar objektin e ri të stacionit policor në Izvor të Zveçanit, dy kilometra larg nga kufiri me Serbinë. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, që mori pjesë në përrurimin e këtij objekti, tha se ai do të shërbejë për sigurinë kufitare dhe për parandalimin e aktiviteteve ilegale. Gurthemeli për këtë objekt të Policisë së Kosovës ishte vendosur më 25 nëntor të vitit të kaluar. Sipas njoftimit të Qeverisë së Kosovës, ky objekt është prej afër 4 000 metrash katrorë dhe për ndërtimin e tij janë investuar 753 mijë euro. Gjatë përrurimit të këtij objekti, Kurti tha se në bazë të marrëveshjeve të Brukselit, pikëkalimi kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë në Zveçan do të duhej të ishte një vendkalim i integruar i kufirit, “por për shkak se Serbia nuk respekton atë çfarë është



dakorduar, edhe më tej ngelet i parealizuar”. “Jemi këtu sot, gjashtë muaj e gjysmë më vonë, për ta bërë përrurimin, inaugurimin e Stacionit të ri Policor për Mbikëqyrjen e Kufirit këtu në Izvor të Zveçanit të Republikës së Kosovës - në një ndërtesë impresive e cila ka kushtuar rreth 750 mijë euro dhe ka një sipërfaqe të gjithëmbarshme prej afër 4 mijë metrash katrorë në mënyrë që edhe zyrtarët policorë të kenë kushte të dinjitetshme të punës, por

edhe performanca të jetë e një cilësie të lartë sa i përket parandalimit të kontrabandës dhe çfarëdo veprimtarie tjetër ilegale”, tha Kurti. Vitin e kaluar institucionet e Kosovës nisën ndërtimin e disa stacioneve dhe nënstacioneve policore në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Institucionet e Kosovës kanë thënë se ato do të ofrojnë më shumë siguri, por nga serbët lokalë dhe Beogradi janë parë si të panevojshme dhe një formë presioni.

PDK-ja NË DRENAS PROPOZON SËRISH RAMIZ LLADROVCIN KANDIDAT PËR KRYETAR KOMUNE

DRENAS, 10 QERSHOR - Kryesia e Degës e PDK-së në Drenas ka miratuar propozimin për kandidaturën e Ramiz Lladrovci për kryetar të komunës për zgjedhjet e 12 tetorit. Lladrovci ka thënë se me punë dhe përkushtim, uniteti i dëshmuar i Degës së PDK-së në zgjedhjet nacionale pret të përsëritet edhe në zgjedhjet lokale, ashtu sikur deri sot të jenë fitues në të gjitha zgjedhjet lokale e qendrore. “Falënderoj Kryesinë e Degës së PDK-së në Drenas për miratimin e propozimit për kandidaturën time për kryetar të komunës për zgjedhjet e 12 tetorit. Votat për kandidaturën time ishin 42 për, një kundër dhe një abstenim. Pres nga kryetari i PDK-së, miratimin e këtij propozimi të Degës e cila nuk njeh humbje nga çlirimi e këndeje. Me punë e përkushtim, uniteti i dëshmuar i Degës së PDK-së në zgjedhjet nacionale, pres të përsëritet edhe në



zgjedhjet lokale, ashtu sikur deri sot të jemi fitues në të gjitha zgjedhjet lokale e qendrore. Drenasi, dje bastion i UÇK-së dhe sot bastion i PDK-së, është i pathyeshëm në rrugën dhe vizionin e heronjve tanë të luftës dhe paqes, Hashimit, Kadriut, Jakupit. Komuna e Drenasit është gjashtë herë kampion i qeverisjes së mirë në nivel nacional, sepse i ka edhe qytetarët më të mirë, degën e PDK-së me organizimin më të mirë, prandaj, mezi pres të vazhdojmë! Besimi që mu dha është jo vetëm detyrë por edhe obligim në shërbim të qytetarëve të komunës së Drenasit!”, ka thënë Lladrovci.

Zafir Berisha largohet nga Nisma, rikthehet në Bashkimin Demokratik

Prishtinë, 10 qershor - Zafir Berisha është larguar nga Nisma Socialdemokrate, ka njoftuar ai në “Facebook”. Ai ka bërë me dije se së

bashku me bashkëpunëtorë do ta rikthejë Bashkimin Demokratik në Prizren. Berisha i ka uruar suksese Nismës Socialdemokrate të

udhëhequr nga Fatmir Limaj. “Të nderuar miq; Nga sot aktivitetin tim politik së bashku me bashkëpunëtorë do ta

rikthejë në Bashkimin Demokratik në Prizren, ndërsa Nismës i dëshiroj suksese! Zafa”, ka shkruar ai.



KMDLNJ BËN THIRRJE QË TË SHMANGEN KALIMET NËPËR TERRITORIN E SERBISË

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut ka theksuar përmes një reagimi për medie se kohën e fundit Serbia ka shpeshtuar arrestimin e qytetarëve të Kosovës me arsyetim se kanë qenë pjesë e UÇK-së.

Po sipas KMDLNj-së, edhe në Maqedoni të Veriut po arrestohen shqiptarët që janë vënë në listën e Interpolit, me kërkesë të Serbisë. “Pastaj po hiqen të zitë e ullirit për të pamundësuar ekstradimin e tyre në Serbi. Arbnor Spahiu, ish-pjesëtar i Policisë së Kosovës ishte arrestuar tre ditë më parë në Serbi në ndërkohë që gjykata përkatëse ia caktoi masën e paraburgimit, 30 ditë. Nga burime të paverifikuara thuhet se është marrë në pyetje për rastin në Banjë të Zveçanit kur pati një sulm paramilitar ndaj Policisë së Kosovës. Thuaja në 95 për qind të rasteve të arrestimit, të arrestuarit ishin pjesëtarë të UÇK-së. KMDLNj në shumë reagime pati kërkuar që ta shmangin kalimin nëpër territor të Serbisë për të shkuar në vendet e tjera. Autoritetet serbe kanë bërë arrestime të përzgjedhura duke e përshtatur me dinamikën e arrestimeve të serbëve në Kosovë. Këto arrestime tashmë po shndërrohen në një ping - pong politik ku më së paku bëhen përpjekje për të siguruar drejtësi për viktimat dhe përgjegjësi për

ata që janë pjesë e zinxhirit të përgjegjësive për krime”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij institucioni, përkundër sigurimit të bazës ligjore për gjykime në mungesë, nga aspekti i të drejtave të njeriut janë të diskutueshme, shpesh duke rënë ndesh me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. “Për shkak të mungesës së bashkëpunimit midis Kosovës dhe Serbisë në fushën e drejtësisë, nuk ka shumë mundësi të sigurohemi se ndaj të arrestuarve në Serbi, qytetarë të Kosovës, respektohen të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria, sipas standardeve ndërkombëtare. Ndërkaq, qytetarët serbë të arrestuar në Kosovë e që kanë thuaja 100 për qind shtetësi të dyfishtë apo edhe për shtetasit e Serbisë të arrestuar në Kosovë, përjashtuar rastet skajshmërisht të rralla, vizitat monitoruese lejohen dhe faktet tregojnë se ata trajtohen plotësisht në përputhje me dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria”, theksohet në këtë reagim.

KMDLNj ka thënë se është në interes, në radhë të parë të familjeve të të arrestuarve, pavarësisht shtetas të cilit shtet janë, pastaj edhe publikut që të sigurohen informata nga burime të paanshme dhe të pavarura për trajtimin e personave të dyshuar e që mbahen të arrestuar në Kosovë, Serbi apo një shteti tjetër



të rajonit. “Prandaj KMDLNj pati propozuar që të bëhet një marrëveshje mbështetur në vullnet të mirë e që iu lejohet monitorimi i papenguar personave të privuar nga liria në Kosovë dhe Serbi. Monitorimi do të bëhej ekskluzivisht nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe raporti i monitorimit do të dërgohej te Shërbimet Korrektuese të shteteve përkatëse që kanë përgjegjësi për trajtimin e personave të privuar nga liria sikur edhe te Ministrinë e Drejtësisë. Për tejkalim të autorizimeve zyrtare dhe profesionale policore gjatë arrestimit dhe mbajtjes policore prej 48 orëve, përgjegjësia do të adresohet te drejtori i Policisë dhe Ministrisë për Punë të

Brendshme. KMDLNj pret që Arbnor Spahiu do të trajtohet në përputhje me të drejtat që i takojnë, se do të ketë vizita të lejuara, mbrojtje dhe mbrojtës për të cilin vet ai përcaktohet dhe se rasti i tij nuk do të politizohet. Vetëm pasi të arrestuarit në Serbi, shtetas të Kosovës janë liruar, KMDLNj ka siguruar prova se ndaj tyre trajtimi policor dhe gjatë mbajtjes ka qenë korrekt”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Edhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se pjesëtarët e UÇK-së dhe familjarët e tyre nuk duhet të udhëtojnë nëpër Serbi. “Gjithë pjesëtarët e institucioneve të rendit dhe të sigurisë, qoftë të liruar nga detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe

familjarët e tyre të ngushtë, s’duhet të udhëtojnë nëpër Serbi. Mos e bëni këtë!”, ka thënë Haradinaj.

Avokati Arianit Koci ka thënë se arrestimi i Arbnor Spahiut është i padrejtë, i motivuar politikisht dhe pa asnjë provë apo bazë faktike. “Kërkoj angazhim të drejtpërdrejtë të shtetit të Kosovës, jo vetëm nga Ministria e Jashtme dhe Zyra Ndërlidhëse në Beograd - por edhe reagim të qartë dhe publik nga kryeministri dhe Presidentja e vendit. Sepse asnjë qytetar i këtij vendi nuk guxon të lihet vetëm, kur persekutohet padrejtësisht. Punën që nuk po e bën shtetit i Kosovës - po më duhet ta bëjë unë”, ka shkruar Koci në “Facebook”.

VDIQ BUJAR BUKOSHI, ISH-KRYEMINISTËR I KOSOVËS NË MËRGIM

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Bujar Bukoshi, ish-kryeministër i Kosovës në mërgim dhe politikan i rëndësishëm i vendit, ka vdekur të martën në moshën 78-vjeçare.

Raportohet se ai vuante nga një sëmundje e rëndë e paspecifikuar.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se lajmin për vdekjen e Bukoshit e “mora me dhimbje të thellë” dhe e përshkroi Bukoshin si një “mjek me vizion dhe një burrë shteti me përkushtim të pasqorë”.

“Kontributi i tij si mjek, intelektual dhe udhëheqës politik ka lënë gjurmë të pashlyeshme në ndërtimin e rrugës sonë drejt lirisë dhe pavarësisë”, tha Osmani, sipas një komunikate të Presidencës.

Ngushëllime familjes Bukoshi i kanë shprehur edhe lideri i PDK-së, LDK-së dhe AAK-së. Ata kanë theksuar se personaliteti i Bujar Bukoshit është i rëndësishëm së veçantë në historikun institucional të

Kosovës, duke qenë pjesë e tyre në ekzil dhe më vonë edhe në liri.

Bukoshi, mjek, urolog, profesor i universitetit, ishte kryeministër i Kosovës në mërgim nga viti 1991 deri në vitin 1999. Ai ishte pjesëmarrës aktiv i lëvizjes politike për pavarësinë e Kosovës.

Bukoshi ishte ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe pas pavarësimit të vendit mbajti disa pozita politike, si deputet i Kuvendit të Kosovës, ministër i Shëndetësisë dhe zëvendëskryeministër.

Bukoshi, i lindur në Suharekë në vitin 1947, mbaroi Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1971, ndërsa tezën e doktoratës në vitin 1985 në Fakultetin e Mjekësisë në Berlin. Gjatë karrierës punoi mjek dhe profesor universitar në Prishtinë. Bukoshi ka lënë pas bashkëshorten, dr. Zana Bukoshi, vajzat Ora, Shota, Nita dhe nipërit Dardan dhe Taulant.



ENERGJIA NË TREG TË LIRË: NDIKIMI NË ÇMIMET E SHËRBIMEVE PUBLIKE

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ndërsa zhurma më e madhe për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë është dëgjuar nga sektori privat, ndërmarrjet publike kanë hyrë në këtë proces pa shumë bujë, por jo pa pasoja. Me çmime të tregut që nuk do të rregullohen më nga shteti dhe me kosto të reja energjetike që priten, pyetja kryesore që shtrihet është: a do të rriten çmimet e shërbimeve publike që qytetarët i marrin çdo ditë?

Ekspertët e ekonomisë paralajmërojnë se ky tranzicion mund të sjellë rritje të tarifave për shërbime esenciale, si uji dhe pastrimi, të cilat varen drejtpërdrejt nga konsumi i energjisë. “Çdo tentim i këtyre ndërmarrjeve për lëvizje të çmimeve, duhet të ndalohet nga pronarët e tyre. E, pronarët e tyre dihet se kush janë - në nivel lokal janë komunat, kurse në nivel qendror është qeveria”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Berim Ramosaj, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës.

Furnizim nga KEK-u

Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës - ZRRE konfirmon për REL-in se, nga 1 qershori, në tregun e hapur të energjisë kanë dalë të gjitha ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale, që kanë mbi 10 milionë euro qarkullim dhe mbi 50 punëtorë.

Këto ndërmarrje janë duke u furnizuar nga Korporata Energjetike e Kosovës, e cila është licencuar nga ZRRE-ja për furnizim komercial me rrymë. Paraprakisht, ato janë furnizuar nga Operatori për Furnizim me Energji - KESCO, me tarifa të rregulluara nga ZRRE-ja. Furnizimi, tani e tutje, do të bëhet me çmime të tregut dhe jo të përcaktuara nga institucionet

shtetërore.

As KEK-u, as ZRRE-ja nuk kanë ofruar informata të detajuara për numrin e ndërmarrjeve publike që kanë nënshkruar kontrata për furnizim me energji në treg të hapur.

Në një komunikatë për media më 5 qershor, KEK-u ka bërë të ditur se ka nënshkruar 15 kontrata komerciale me konsumatorë që kanë zgjedhur furnizim të drejtpërdrejtë, por nuk ka saktesuar nëse bëhet fjalë për ndërmarrje publike apo private. Përveç KEK-ut, në Kosovë janë të licencuara edhe 20 kompani të tjera për furnizim me energji elektrike, ndërsa një tjetër ndodhet në proces të licencimit.

Sfidat financiare

Aktualisht, në vend funksionojnë 18 ndërmarrje publike qendrore dhe rajonale, të cilat operojnë në sektorë të ndryshëm si: energjia, transporti, telekomunikacioni, shërbimet postare, menaxhimi i mbeturinave, ujësjellësi e të tjera.

Përveç tyre, sipas Institutit për Hulumtime të Avancuara - GAP, ekzistojnë edhe 55 ndërmarrje publike lokale. Blendi Hasaj, nga ky institut, vlerëson për Radion Evropa e Lirë se ndërmarrjet publike me performancë të mirë, mund të arrijnë t'i ruajnë çmimet aktuale të shërbimeve, por ato që ndër vite janë përballur me vështirësi financiare, do të kenë sfida për shkak të rritjes së kostonë së energjisë elektrike. “Ky realitet na çon te një pikë kyçe: këto kompani ose duhet t'i rrisin çmimet e shërbimeve, ose duhet të ndërhyjë qeveria. Një prej mundësive është që qeveria t'i subvencionojë këto ndërmarrje, sepse nuk besoj se do të ishte e përshtatshme që të gjitha shër-



bimet publike të shtrenjtoheshin përnjëherë”, thotë Hasaj. E pyetur nga Radio Evropa e Lirë për mundësinë e tillë të subvencionimit, Qeveria e Kosovës nuk u përgjigj.

REL-i ka kontaktuar edhe disa prej ndërmarrjeve publike - përfshirë Telekomin e Kosovës, Postën, Trepçën, Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina”, Kompaninë Rajonale “Pastrimi”, Kompaninë për Menaxhimin e Deponive dhe Trafikun Urban - për t'i pyetur nëse dalja në tregun e hapur do të ndikojë në rritjen e çmimeve të shërbimeve që ato ofrojnë.

Nga të gjitha këto, vetëm Telekom i Kosovës/VALA ka kthyer përgjigje, duke deklaruar se çdo rritje e kostonë, përfshirë edhe ato të energjisë, ndikon drejtpërdrejt në çmimin e shërbimeve që ofron kompania. “... por, ne do të bëjmë përpjekje - për aq sa është e mundur - që kjo kosto shtesë të reflektohet sa më pak në çmimin e shërbimeve për konsumatorët”, tha Fadil Lepaja, udhëheqës i Zyrës për

Komunikim në këtë kompani. Sipas tij, Telekomu paguan rreth 1.5 milion euro në vit për faturat e energjisë elektrike.

Çfarë thonë bizneset për liberalizimin e energjisë?

Bashkë me ndërmarrjet publike, në tregun e lirë të energjisë kanë hyrë edhe rreth 1 300 biznese private. Por, hapja e këtij tregu ka nxitur reagime të forta dhe shqetësime të shumta për çmimet dhe gatishmërinë e vendit për këtë ndryshim. Përfaqësuesit e biznesit kërkojnë me ngulm shtyrjen e liberalizimit për së paku një vit, duke argumentuar se çmimet që ofrojnë kompanitë e licencuara për furnizim, janë shumë më të larta sesa ato të përcaktuara nga shteti, ndërsa një pjesë e tyre nuk kanë paraqitur ende oferta në treg.

Në këtë situatë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka kërkuar ZRRE-së pezullimin urgjent të procesit deri në plotësimin e kushteve thelbësore. “Vetëm pak ditë pas hyrjes

në fuqi të liberalizimit, së paku dy kompani prodhuese i kanë pezulluar operacionet, duke përmendur si arsye kostonë e larta të energjisë elektrike. Institucionet shtetërore janë informuar për këto zhvillime”, thuhet në komunikatën e saj për media të lëshuar më 5 qershor.

Liberalizimi i tregut energjetik është një kërkesë e Bashkimit Evropian dhe parashikohet në Traktatin e Komunitetit të Energjisë që Kosova e ka nënshkruar që nga viti 2005, së bashku me vendet e tjera të rajonit.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë gjithashtu tregje të liberalizuara energjetike. Edhe në këto dy vende fillimisht kishte rezistencë, por sot procesi shihet si mundësi për menaxhim më të mirë të kostonë energjetike. Në Kosovë, megjithatë, ky tranzicion ndodh në një moment sfidues ekonomik - sipas një ankete të fundit të Eurobarometrit, 45 për qind e qytetarëve thonë se përballja me shpenzimet për mbijetesë është brenga e tyre kryesore.

BIZNESET SËRISH NË PROTESTË KUNDËR LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), së bashku me përfaqësues të bizneseve nga e gjithë Kosova, sërish do të mbajnë një protestë të mërkurën, me fillim nga ora 11:00 deri në 12:00, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë. Kjo protestë synon ta kundërshtojë mënyrën se si bizneset janë detyruar të hyjnë në tregun e lirë të energjisë elektrike, pa pasur përgatitje të mjaftueshme.

Kryetari i OEK-së, Lulzim Rafuna, në një konferencë për medie theksoi se protesta do të jetë paqësore dhe bëri thirrje që qeveria ta rishikojë vendimin e marrë.

Ai tha se kërkojnë një afat njëvjeçar dhe një paketë ligjore për ta lehtësuar tranzicionin për biz-



neset dhe për t'i mbrojtur qytetarët. “Protesta do të mbahet nesër nga ora 11:00 deri në 12:00. I ftojme të gjithë ata që preken nga ky vendim të na bashkohen për të mirën e vendit. Kërkojmë që qeveria të

reflektojë dhe ta mbështesë biznesin dhe ekonominë, duke dhënë një afat të përshtatshëm për kalimin në tregun e lirë dhe duke përgatitur masa ligjore për këtë tranzicion”, ka thënë Rafuna. Ai shtoi se nëse qeveria

nuk ndryshon qëndrim, bizneset do të detyrohen t'i vazhdojnë protestat. Rafuna kritikoi ZRRE-në për mungesën e përgatitjes dhe ofertave të mjaftueshme për konsumatorët në tregun e lirë të

energjisë.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit (AKB), Agim Shahini, ka deklaruar se takimi me përfaqësuesit e KEK-ut nuk solli përgjigje të kënaqshme. “1 300 biznese dhe familjet e punëtorëve të tyre janë në një situatë të vështirë. Ndërsa bizneset vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e tyre, njëkohësisht po përgatiten për protestën e nesërme, e cila pritet të jetë shumë e madhe”, ka theksuar Shahini, duke kërkuar që qeveria ta shtyjë zbatimin e vendimit për një vit.

Skender Krasniqi, kryetar i Dhomës së Tregtisë në Kosovë, ka thënë se nga 1 300 biznese që janë përfshirë në procesin e liberalizimit, vetëm tri kanë arritur marrëveshje me KEK-un.

TRUMP KA PUSHTET, NJË MEGAFON TË MADH DHE MILIARDA PËR TË SHPENZUAR. PO KËTO I KA EDHE MUSK

Presidenti Trump ndodhet në një përplasje me njeriun më të pasur të botës, i cili nuk është aspak një kundërshtar i zakonshëm.

Që kur mori detyrën në janar, Presidenti Trump është përballur me pak ose aspak opozitë me peshë.

Kongresi ka qenë i bindur dhe dukshëm i paimentuar për të ushtruar mbikëqyrje. Ai ka anashkaluar gjykatat për të vendosur vullnetin e tij mbi politikatat e imigracionit dhe për të marrë hak ndaj firmave ligjore dhe universiteteve. Mediat konservatore e kanë mbështetur atë dhe agjendën e tij, ndërsa disa media kryesore janë treguar të përmbajtura.

Por tani, Trump nuk po përballët vetëm me një kundërshtar të fuqishëm për herë të parë këtë vit — ai po përballët drejtpërdrejt me një rival të zemëruar si Elon Musk, i cili ka kapacitetin për të vazhduar betejën dhe ndan me presidentin instinktin për të goditur rëndë kundërshtarët dhe për të përdorur çdo mjet, për të fituar qoftë edhe një përparësi afatshkurtër.

Është një sfidë e re për Donald Trumpin, i cili gjithmonë ka pasur talentin për të trembur dhe poshtëruar rivalët dhe për të përdorur rrjetet sociale dhe fuqinë e presidencës për të shkatërruar çdo opozitë.

Musk, i cili zotëron X dhe ka 220 milionë ndjekës, mund të konkurrojë ose ndoshta të tejkalojë fuqinë e zërit të Trump në rrjetet sociale, duke pasur parasysh shtrirjen e kufizuar të Truth Social, platformës së presidentit.

Nëse do të ishte një përballje e ngjashme me ngacmuesit në shkollë ose përbindëshat kinematografikë, do të ishte një betejë e vërtetë.

“Është tamam si Godzilla kundër Kongut,” tha Costas Panagopoulos, profesor i shkencave politike në Universitetin Northeastern. Por përtej tërheqjes që ka kjo përballje mes dy njerëzve më të fuqishëm në botë, ka shumë gjëra në lojë.

Beteja e tyre vjen në një moment kur Trump po zhvillon një manovër delikate në Kongres për të kaluar legjislacionin e tij kryesor, të quajtur “Projektligji i Madh i Bukur,” si dhe për të negociuar mbylljen e disa konflikteve të jashtme, që kanë qenë shumë më të vështira sesa kishte parashikuar.

Nuk është e qartë se sa gjatë do të vazhdojë përplasja e tyre, të paktën me intensitetin që u pa të enjten. Dhe Musk, pronar i SpaceX dhe Tesla, ka shumë për

të humbur nga një betejë e zgjatur me Trumpin, i cili ka një kontroll të fortë mbi Partinë Republikane dhe fuqinë për të dëmtuar interesat e Musk.

Por konflikti i tyre ka nxjerrë për herë të parë në pah disa dobësi të Trumpit, që më parë ishin mbuluar.

Zakonet e shpenzimeve të mëdha të presidentit kanë irrituar prej kohësh një grup të vogël ligjvënësish me prirje libertariane, të cilët shpesh shprehin shqetësime për borxhin në rritje të vendit, por zakonisht janë detyruar të heshtin. Tani, me Musk që i bashkohet kauzës së tyre, ata kanë më shumë mbështetje, duke rrezikuar kalimin e projektligjit që mbart agjendën e brendshme të Trumpit, e cila përfshin miliarda në ulje taksash, financim për murin kufitar dhe kufizime për Medicaid — por gjithashtu edhe një rritje të tavanit të borxhit.

Përplasja Trump-Musk mund të kthehet gjithashtu në një shpërqendrim të madh tek administrata përpiket të zhvillojë negociatat të vështira në çështje tregtare, lufte dhe paqe, përfshirë edhe me Rusinë, Iranin dhe Kinën. Musk sugjeroi të enjten se strategjia e tarifave e Trumpit, mund të shtyjë Shtetet e Bashkuara drejt një recesioni më vonë këtë vit, një shqetësim që ndajnë edhe disa ekonomistë.

Ekziston gjithashtu çështja e punëve të rëndësishme të Musk në fushën e hapësirës përmes kompanisë së tij SpaceX, nga e cila qeveria federale varet shumë. Pasi Musk sulmoi presidentin, Trump kërcënoi të anulonte kontratat e tij. Biznesmeni miliarder tha se do të fillonte çmontimin e një kapsule që përdoret për të transportuar astronautë dhe furnizime në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës. Todd Belt, drejtor i programit të menaxhimit politik në Universitetin George Washington, parashikoi se nëse të dy nuk i zbusin marrëdhëniet, mund të përfundojnë duke mbështetur kandidatë të ndryshëm në zgjedhjet paraprake republikane në vitin 2026.

“Elon Musk është një njeri që i pëlqen të rrezikojë, dhe bizneset e tij janë aq thellësisht të lidhura me qeverinë sa që nuk mund ta shohësh të largohet nga politika,” tha Belt. “Kështu që mendoj se, në fund, mund të shohim kandidatë të Musk dhe kandidatë të Trump në parapraket e 2026-ës.”

Trump u ngjit në politikë pjesërisht falë talentit të tij për



të identifikuar dobësitë e kundërshtarit dhe për t'i tallur ata pa mëshirë. Shprehjet e tij, si “Jeb pa energji” Bush dhe “Marco i vogël” Rubio, ndihmuan në shkatërrimin e fushatave rivale dhe ose i larguan kundërshtarët nga politika, ose i detyruan të përkulen para tij.

Por tani, te Musk, ai ka gjetur një kundërshtar që zotëron aftësi të forta në rrjetet sociale dhe një prirje për të goditur poshtë brezit. Gjatë gjithë ditës së enjten, të dy shkëmbyen goditje në platformat e tyre sociale: Trump e sulmoi Musk në Truth Social, duke sugjeruar se kundërshtimi i tij ndaj projektligjit ishte i motivuar nga lakmia dhe dëshira për subvencione për automjetet elektrike për Teslën; ndërsa Musk e ofendoi presidentin në platformën e tij shumë më të madhe, X, dikur e njohur si Twitter.

Edhe pse përplasja mes Trump dhe Musk filloi si një mosmarrëveshje për politika, ishte Musk ai që e baltosi shpejt, duke sugjeruar se presidenti mund të ishte i përfshirë në hetimin për trafik

seksual të Jeffrey Epstein, një multimilioner që vari veten në një burg federal në Nju Jork në vitin 2019.

Më pas ai mbështeti shkarkimin e Trump nga detyra dhe premtoi se do të qëndronte më gjatë në politikë se ai.

“Trump ka edhe 3.5 vite si president,” shkroi Musk në X, “por unë do të jem vërdallë edhe për 40 vjet të tjera.” Presidenti, i cili fillimisht kishte përdorur kritika të buta duke thënë se ishte “i zhgënjyer” nga Musk, deklaroi shpejt se miliarderi kishte “çmendur fare!”


Aleatët e Trumpit e morën betejën në dorë dhe dolën në krah të tij: Stephen K. Bannon, një nga ish-këshilltarët e presidentit, bëri thirrje që Musk të deportohej. Ndërsa mbështetësit e Musk, nga ana tjetër, e sulmuan presidentin në internet, madje edhe në platformën e tij.

“Trump gjithmonë ka qeverisur përmes kaosit, por kushdo që mendonte se një mandat i dytë do të ishte i disiplinuar dhe i qetë, tashmë është çliruar nga ky iluzion,” tha William G. Howell, dekani i Fakultetit të

Shkencave të Qeverisjes dhe Politikave në Universitetin Johns Hopkins. “Dhe megjithatë, edhe kur e di çfarë po vjen, është e vështirë të mos befasohesh vazhdimisht nga niveli i helmit dhe sa publik dhe i menjëhershëm është. Është vërtet e jashtëzakonshme.”

Në Kongres, republikanët janë treguar të kujdesshëm për të mos thënë asnjë fjalë të keqe për asnjërin dhe shpresojnë se mund ta presin këtë luftë fjalësh pa pasur nevojë të marrin anë. Ata janë prej kohësh të frikësuar të kundërshtojnë Trumpin, dhe këtë javë, ndërsa Musk e sulmonte projektligjin e presidentit, ata u përpoqën të qetësonin miliarderin, edhe pse ai kërcënonte t'i rrëzonte nëse mbështesnin agjendën e Trumpit.

Senatori Mike Lee, republikan nga Utah, e përmbledhi situatën e vështirë në të cilën ndodheshin ligjvënësit republikanë, si një fëmijë që duhet të zgjedhë me cilin prind të qëndrojë pas divorcit. “Por ... unë i dua të dy,” shkroi Lee në X. / NYT – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Selmani paraqitet tek Egnatia

Sulmuesi i krahut, Kastriot Selmani, karrierën do të vazhdojë në Kategorinë Superiore të Shqipërisë. Selmani do të jetë pjesë e

skuadrës së Egnatias, pasi kampionia e Shqipërisë të martën e ka bërë prezantimin e tij. Me skuadrën nga Rrogozhina, Selmani ka

firmosur kontratë dyvjeçare dhe pritet të jetë lojtar i rëndësishëm për trajnerin Edlir Tetova. Selmani së fundmi është shpallur

kampion i Kosovës me Dritën, skuadër për të cilën ka luajtur tre vjet, kurse karrierë në Kosovë ka bërë edhe te Llapi, Prishtina dhe

Vushtrria. 25-vjeçari do të paraqitet me Egnatian në kualifikimet e Ligës së Kampionëve për sezonin 2025/26.

Mediet çeke lavdërojnë Rrahmanin



PRAGA, 10 QERSHOR - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Albion Rrahmani, po tregon formë të mrekullueshme me “dardanët”. Në dy ndeshjet miqësore që Kosova i zhvilloi ndaj Armenisë dhe Komoreve, “Lewa” shënoi pesë gola - dy kundër armenëve dhe tre gola kundër Komoreve. Mediet çeke kanë lavdëruar paraqitjet e Rrahmanit, i cili luan për Sparta Pragën. “Ndërsa ekipi kombëtar çek i futbollit humbi në mënyrë të turpshme ndaj Kroacisë, ekipi i Kosovës ende nuk e ka filluar kualifikimin dhe ka luajtur dy ndeshje përgatitore. Ata i fituan të dyja bindshëm dhe, përveç kësaj, një sulmues shumë i njohur për tifozët çekë u shfaq. Albion Rrahmani shënoi dy

herë kundër Armenisë për herë të parë dhe disa ditë më vonë shënoi një hat-trick kundër Komoreve”, shkruan mediet çeke “ruik”. Albion Rrahmani kaloi te Sparta verën e kaluar për 5 milionë euro nga Rapidi i Bukureshtit. Te klubi i ri, sulmuesi nga Kosova pati disa ndeshje të shkëlqyeshme, ndonëse nuk arriti kurrë të ishte në formacionin startues. Kështu, u spekulua se ai do të largohej dhe klubi do ta shiste me humbje. Megjithatë, siç raporton “Ruik”, informacionet e fundit janë kontradiktore dhe duket se Rrahmani do të luftojë nën drejtimin e trajnerit të ri Brian Priske. Ky medium thotë se tifozët mezi presin të shohin se çfarë do t'i bëjë Rrahmanit

ardhja e trajnerit Priske. Rrahmani do të luftojë përsëri për pozicionin numër një me Jan Kuchtan, me të cilin Priske ka një marrëdhënie të shkëlqyer, por tani që po afrohen ndeshjet e fazës së ligës të Ligës së Konferencës, të dy padyshim do të kenë shanset për t'u dëshmuar. Dhe do të varet nga ata se cili do ta zë vendin e titullarit te Sparta. Pas fitores ndaj Komoreve, Rrahmani u shpreh tejet i lumtur me paraqitjet e tij. “Jam shumë i kënaqur me këto dy ndeshje. Jam shumë i lumtur dhe krenar që arrita ta ndihmoj kombëtaren. Topi i ndeshjes pas ‘hat-tricku’-t do të jetë kujtim shumë i bukur. Foda më dha 2 ndeshje, 5 gola nuk është keq”, ka thënë Rrahmani.

SHKURT

Khaka nuk largohet nga Leverkuseni

Mesfushori Granit Khaka duket se ka marrë vendim përfundimtar për të ardhmen e tij, kanë raportuar mediet gjermane. Mësohet se Khaka i ka bërë me dije Bayer Leverkuseni se nuk dëshiron të largohet këtë verë përkundër interesimit të madh nga skuadrat e tjera. Edhe Leverkuseni nuk është i interesuar ta shesë Xhakën pasi trajneri Erik Ten Hag llogarit në mesfushorin 32-vjeçar. Në fakt, Khaka dhe Leverkuseni janë pajtuar se do ta merrnin në konsideratë ndarjen, vetëm në rast të ndonjë oferte të majme. Khaka është pjesë e Leverkuseni prej vitit 2023 dhe ka kontratë deri në vitin 2028, ndërsa kohët e fundit interesim për shërbimet e tij kanë shfaqur Milani, Galatasaray, Fenerbahçe e disa skuadra nga Arabia Saudite.

Kjo është shuma që Beshiktashi e kërkon për Rashicën

Milot Rashica pritet të largohet nga skuadra e Beshiktashit këtë verë. Mediet turke kanë njoftuar të martën se Beshiktashi tashmë ka caktuar çmimin për Rashicën që e ka nxjerrë në shitje. Rashica nuk bën pjesë në planet e trajnerit Ole-Gunnar Solskjaer, kurse Beshiktashi për shërbimet e tij kërkon 6 deri në 8 milionë euro. 28-vjeçari ka oferta nga Turqia, por edhe Gjermani, ku mësohet se Borussia Monchengladbachu do të bëjë ofertë zyrtare për shërbimet e tij. Rashica iu bashkua Beshiktashit në vitin 2023 dhe ka kontratë me ekipin turk deri në verën e vitit 2027.

Bero Kingdom triumfon në edicionin e parë të Alley Oop

Prizren, 10 qershor - Bergo Kingdom nga Prizreni është fitues i edicionit të parë të Alley Oop të mbajtur në Kosovë. Në superfinalen e zhvilluar në Prishtinë, kanë marrë pjesë gjashtë finalistët e gjashtë qyteteve pjesëmarrëse të këtij turneu. Në superfinalen e mbajtur në kryeqytet kanë marrë pjesë: Prishtina, Bero Kingdom nga Prizreni, 02 nga Mitrovica, Art Design nga Theranda, 03 nga Peja dhe El Quadro nga Gjakova. Fillimisht u zhvilluan nga dy ndeshje në grupe, e më pas, gjysmëfinalet, si dhe finalja fantastike mes Bero Kingdom dhe 03, ku triumfuan prizrenasit. Çmimin prej 1000 eurosh për skuadrën fituese e ka ndarë Granit Rugova, drejtor i programeve dhe projekteve zhvillimore në FBK. Ky projekt ishte në partneritet me FIBA Evropën, derisa qëllimi është ta masivizojë basketbollin 3x3 në të gjithë Kosovën. Ky ishte edicioni i parë, derisa në edicionin e ardhshëm do të jetë më masiv edhe në shumë qytete të Kosovës.

Nora Gjakova në garë për pozitë të rëndësishëm në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos

PRISHTINË, 10 MAJ - Nora Gjakova është kandidatja zyrtare e Federatës së Xhudos së Kosovës për Komisionin e Atletëve të IJF (Federata Ndërkombëtare e Xhudos) në JudoWorlds që do të mbahet në Budapest. Kampione olimpike, medaliste e bronzitë në Botëror dhe tetë herë medaliste në Evropian, Nora e ka

përfaqësuar me krenari Kosovën në tri Lojëra Olimpike, duke qenë gjithmonë shembull frymëzimi brenda dhe jashtë tatamit. Tani ajo është e gatshme t'i përfaqësojë zërat e sportistëve në skenën globale, duke sjell përvojën, integritetin dhe pasionin e saj për xhudon në zemër të vendimarrjes.

Zgjedhjet do të mbahen gjatë Kampionatit Botëror të Xhudos për Senior (13-19 qershor 2025) në Hungari. Vetëm sportistët e akredituar në Kampionatin Botëror mund të votojnë. “Jemi krenarë të njoftojmë se Nora Gjakova është kandidatja zyrtare e Federatës së Xhudos së Kosovës për Komisionin e

Atletëve të IJF (Federata Ndërkombëtare e Xhudos) në JudoWorlds që do të mbahet në Budapest. Le ta mbështesim Norën në këtë hap të rëndësishëm drejt formësimit të së ardhmes së xhudos për sportistët anëmbanë botës”, thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës.



Huijsen paraqitet te Real Madridi

Madrid, 10 qershor - Real Madridi e ka paraqitur edhe zyrtarisht gjatë ditës së martë Dean Huijsen si transferimin e parë të sezonit të ardhshëm. 20-vjeçari u transferua nga Bournemouth për një shumë prej 58 milionë eurosh, vlera e klauzulës së lirit të tij, duke

nënshkruar një kontratë pesëvjeçare deri në vitin 2030. Spanjoli nënshkroi kontratën me presidentin e klubit, Florentino Perez, sot pasi përfundoi testet mjekësore, më pas iu paraqit fanella e Real Madridit. Sipas raporteve të javës së kaluar, Huijsen do ta

mbajë numrin 24. I riu më parë ka veshur numrin 2 te Bournemouthi, i zënë aktualisht nga Dani Carvajal, ndërsa me Spanjën ka përdorur numrin 12, i cili është i lirë, por mund të rezervohet për Trent Alexander-Arnold. Prandaj, Huijsenit iu dha numri 24, një

numër që kanë veshur legjenda të klubit si Sami Khedira, Claude Makelele, Aitor Karanka dhe Nacho Fernandez. I fundit që ka veshur këtë numër ishte Arda Guler, i cili e përdori në sezonin e tij të parë, para se të kalonte te numri 15 në 2024-2025.



Rama: Po diskutojmë për të sjellë ‘The Globe Soccer Awards’ në Shqipëri

Tiran, 10 qershor - Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se po zhvillohen diskutime me organizatorët për ta sjellë në Shqipëri aktivitetin “The Globe Soccer Awards”. “Po diskutojmë së fundmi për ta sjellë në Tiranë, sepse jemi duke diskutuar si opsione dhe Durrësin dhe Vlorën, edicionin evropian të çmimit të globit të futbollit. Është një eveniment i jashtëzakonshëm që mbahet në mënyrë të përvitshme sa i përket vetë edicionit global në Dubai dhe për edicionin evropian, organizatorët janë në një diskutim me Madridin dhe me ne. Kemi shumë arsye të besojmë se zgjedhja do të bjerë mbi ne dhe do të jetë fantastike që, për shembull, çmimin e futbollistit më të mirë të vitit nga Globe Soccer, Yamalit fjala vjen t’ia japim këtu në Tiranë. Po punojmë edhe me Padel International. Është një tjetër aktivitet i jashtëzakonshëm që ka mbulim të jashtëzakonshëm mediatik në të gjithë botën dhe po punojmë që të sjellim në Shqipëri një edicion të tij”, ka



thënë Rama.

Gjithashtu, në rubrikën e tij “Sy m’sy”, Rama foli edhe për investimet e huaja duke thënë se janë në diskutime në fushën e zhvillimit ekonomik, turizmit, teknologjisë si dhe inteligjencës artificiale. “Ka gjëra shumë të nevojshme sa iu përket të rinjve apo fëmijëve, konkretisht për sportin në shkollë. Do të punojmë për të krijuar hapësira për talente për disiplina të tjera. Disiplina për sportin individual të mundjes, peshëngritjes dhe shahut. Duke kaluar edhe përmes gjimnastikës, për të cilën do të hapim një kapitull të

ri falë bashkëpunimit me një shqiptar të talentuar, një djalë i ri emigrant në republikën çeke, i cili, së bashku me një grup, zotëron klubin më prestigjioz të gjimnastikës në Republikën Çeke, klubin SKH që është themeluar në 1984, ka një kompleks fantastik në qendër të Pragës. Sot ne do të kemi një diskutim më të thelluar për të sjellë këtë palestër prestigjioze, fillimisht në Tiranë dhe për ta përdorur dhe për ta shtrirë sportin në shkollë në një disiplinë sfiduese, siç është gjimnastika”, ka deklaruar Rama.

Ter Stegen ndihet i tradhtuar nga Barcelona

BARCELONË, 10 QERSHOR - Ylli i Barcelonës, Marc-Andre Ter Stegen, është ndier thellësisht i zhgënjyer nga sjellja e fundit e drejtuesve të klubit në prapaskenë në “Camp Nou”. Sipas “Diario Sport”, e hëna solli detaje të reja mbi tensionin në rritje mes portierit gjerman dhe klubit katalanas. Ter Stegen është përfshirë në mënyrë të dukshme në titujt e medieve në Katalonjë gjatë javëve të fundit, pasi ka dalë në pah se mbërritja e Joan Garcia nga Espanyoli pritet ta largojë portierin e parë afatgjatë të Barcelonës nga skuadra. Një sërë raportesh të fundit në medie kanë portretizuar Ter Stegen në



mënyrë negative. Fundjavën e kaluar u raportua se 33-vjeçari refuzoi të udhëtonte për ndeshjen e kthimit të gjysmëfinaleve së Ligës së Kampionëve ndaj Interit të Milanos, si dhe nuk pranoi të fliste publikisht me tifozët gjatë festimeve për titullin në La Liga.

Këto “rrjedhje” të informacionit nuk kanë kaluar pa u vënë re nga Ter Stegeni dhe rrethi i tij i afërt. “Ter Stegen konsideron se Barcelona ka vepruar në mënyrë tradhtare. Askush nuk i ka komunikuar në fund të sezonit se nuk llogaritet më, ndërsa ka parë të shfaqen në medie informacione të diskutueshme mbi sjelljen e tij në dhomat e zhveshjes – gjë që gjermani e sheh si rrjedhje të qëllimshme për t’i dëmtuar imazhin”, thuhej në raportin e gazetës katalanase “Sport”. Për pasojë, është parashikuar një “luftë guerile” mes dy palëve, e cila pritet të përshkallëzohet në javët e ardhshme.

SHKURT

Kalendari i Botërorit të vitit 2026, Spanja i rrëmben një pistë Italisë

Nuk ka shumë surpriza në kalendarin e vitit 2026 që Formula 1 zyrtarizoi herët në mëngjes. E vetmja veçori e re është hyrja e garës së Çmimit të Madh të Madridit në vend të asaj të Emilia Romagna në Imola (Itali). Ngjarja në kryeqytetin spanjoll është shënuar me një yll sepse pista madriline duhet të miratohet ende. Dhe nëse ka ndonjë vonesë, atëherë Imola mund të kthehet në garë për ta zëvendësuar Madridin. Numri i garave nuk ndryshon, 24 të tilla. Gara e parë do të nisë më 8 mars në Melburn të Australisë. Në nivel logistik, gara e Montreal (Kanada) është sjellë pas asaj në Majemi. Sezioni evropian do të ketë nëntë gara, e para në Monako dhe i fundit në Madrid më 13 shtator. Kampionati 2026 do të përfundojë me një “hat-trick” në tri fundjavë radhazi, nga Las Vegas, Katar, për të përfunduar në Abu Dhab.

Bayerni për Leao ofron 60 milionë dhe një lojtar

Rafael Leao mund të largohet nga Milani. Bayern Munchen pritet t’u bëjë një ofertë kuqezinje për anësin portugez dhe në klubin bavarez flitet për 60 milionë euro plus një lojtar, njëri midis Kingsley Coman dhe Kim Min-jae. Si Coman ashtu edhe Kim vlerësohen në maksimum nga Massimiliano Allegri, i cili u emërua trajner i Milanit vetëm pak ditë më parë. Oferta zyrtare e klubit gjerman për sulmuesin portugez nuk është dërguar ende por, përveç ndonjë surprize, propozimi duhet të mbërrijë në Via Aldo Rossi këtë javë.

Ranieri refuzon ofertën e Italisë

Claudio Ranieri e ka refuzuar mundësinë ta drejtojë kombëtaren italiane. Ky vendim i tij është mirëpritur nga fansat entuziastë të Romës. Tekniku i pensionuar do të vazhdojë te Roma si këshilltar i lartë i klubit pasi klubi tashmë ka emëruar trajnerin e ri, Gian Piero Gasperini. Në një deklaratë të shkurtër për agjencinë e lajmeve ANSA, Ranieri sqaroi vendimin e tij. “E falënderoj presidentin Gravina për mundësinë. Nder i madh, por kam reflektuar dhe vendosur të mbes në dispozicion të Romës në rolin tim të ri”, citohet të ketë thënë Ranieri. Ai theksoi se vendimi për ta refuzuar ekipin kombëtar “është vetëm i imi”. Ranieri u emërua në nëntor si kryetrajner i Romës me klubin që gjendej në vendin e 16 në Serinë A, të cilin e ndihmoi të përfundonte një pikë larg kualifikimit në Ligën e Kampionëve, në vendin e pestë. Luciano Spalletti tha të dielën se ishte shkarkuar nga detyra e trajnerit përpara Kupës së Botës 2026, pas një humbjeje 3-0 ndaj Norvegjisë të premtën – ndeshja e tyre e parë kualifikuese për turneun.

Juventusit konfirmon Tudorin në stol edhe për sezonin 2025-2026

Drejtori i ri i përgjithshëm i Juventusit, Damien Comolli, ka konfirmuar se Igor Tudor do të mbetet në krye të skuadrës edhe pas përfundimit të Kupës së Botës për Klube. Comolli, i cili u paraqit zyrtarisht të martën në një konferencë për shtyp në ‘Allianz Stadium’, foli

për herë të parë për mediet italiane dhe një nga temat kryesore ishte pikërisht e ardhmja e trajnerit kroat. Tudor u emërua trajner në mars, duke zëvendësuar Thiago Mottan, dhe kontrata e tij u zgjat automatikisht deri në vitin 2026 pasi siguroi kualifikimin në

Ligën e Kampionëve. Megjithatë, Juventusit ka një opsion për ta ndërprerë kontratën e trajnerit me pagesën e vetëm 1 milion eurove deri më 31 korrik 2025. Klubi, gjithashtu, kishte zhvilluar më parë bisedime me Antonio Conten dhe Gian Piero

Gasperinin, por Comolli e bëri të qartë se Tudor do të vazhdojë të jetë trajner i Juventusit për sezonin e ardhshëm. “Unë mund të konfirmoj se Tudor do të jetë trajner edhe për sezonin e ardhshëm, përtej Kupës së Botës për Klube”, ka thënë Comolli për Ilbianconero.com.

Comolli ka mbajtur disa role të rëndësishme në futboll, përfshirë ato të skautit kryesor dhe presidentit. Ai ishte më parë president i Toulouses dhe ka pasur përballje direkte me Tudorin gjatë kohës që ky i fundit drejtonte Marseille në Ligën 1.



10.06.2025 961/25

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 360/25 të datës 10.06.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L “Përparimi” Sh. A, me datë 10.06.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

- I. Titulli:** Pastrues i Zyrave dhe Objekteve
Numri i ekzekutuesve: 2
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore
Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune
I raporton: Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
Koeficienti i pagës: 390.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimi.
- Certifikatën shëndetësore.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 11.06.2025 deri me datë 25.06.2025 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 02.07.2025.
- Afati për ankesë nga data 03.07.2025 deri me datë 07.07.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 17.07.2025.

- Afati për ankesë nga data 18.07.2025 deri me datë 21.07.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 28.07.2025.
- Afati për ankesë nga data 29.07.2025 deri me datë 31.07.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 06.08.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ Përfundim

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lumturije Arifi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. “Dy Dëshmorët” Sheremet Gjakovë. Nga kl. 1-8.

- Bekë Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. “8 Dëshmorët” Kralan Gjakovë nga kl. 1-8.

- Hysen Arifi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. “Dy Dëshmorët” Sheremet Gjakovë, nga kl. 1-8.

- Fadil Deva shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1. 2. 3. 4 të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Hasan Tolaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.13 dhe diplomën e Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” Deçan.

- Haziz Gegollaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Pjeter Bogdani” Lubizhd e Hasit.

- Ejup Mehmeti shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Basit Mexhiti shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

“Globus Travel” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues” 810108937.

Dr. Luan Krasniqi Specialist i Radiologjisë-Radioterapisë shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës me nr: KO-03688-01-02/1.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, bane-sa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për infor-mata në tel. 044/171-328.



961/25
10.06.2025

U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përparimi" Sh. A a na osnovu rješenja br. protokola 960/25 od **10.06.2025**.godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L "Përparimi" Sh. A od **10.06.2025**, saopštava:

JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Čistač kancelarija i objekata
Broj izvršilaca: 2
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja
Stručna priprema: Osnovna škola
radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo
Izvršava: Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata
Koeficijent plate: 390.00 Euro Bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od nadređenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i drugih obaveza u vezi sa radnim mestom a na osnovu zahteva pretpostavljenog;
- Obavlja druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;
- Za poslove koje obavlja odgovoran je rukovodiocu Jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata;

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Progres" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

➤ **Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti**

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ **Način vrednovanja kandidata.**

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ **Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:**

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

➤ **Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošľovania.**

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od **11.06.2025** do **25.06.2025** u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijave kandidata najkasnije do **02.07.2025.**
- Rok za žalbu je od **03.07.2025** do **07.07.2025.**
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do **17.07.2025**
- Rok za žalbu je od **18.07.2025** do **21.07.2025.**
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do **28.07.2025.**
- Rok za žalbu je od **29.07.2025** do **31.07.2025.**
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspešnog kandidata najkasnije do **06.08.2025.**

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske

službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Peparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu
vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijat će se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ **Objašnjenje**

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ ZAKLJUČAK

NPL "Preparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.



Gjeji PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjeji Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Llapashtica Farm” shpk, Llapashticë e Poshtme, Podujevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Fermën e Lopëve dhe Thertoren, në Llapashticë të Poshtme, Podujevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.07.2025 në ora 14:00 në objektin e SHFMU “Dituria” Llapashticë e Poshtme, Podujevë do të organizohet debat publik nga Kompania “Llapashtica Farm” shpk, Llapashticë e Poshtme, Podujevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Llapashtica Farm” shpk, Llapashticë e Poshtme, Podujevë, për Pëlqim Mjedisor, – për Fermën e Lopëve dhe Thertoren, në Llapashticë të Poshtme, Podujevë

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Komuna e Suharekës, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Ndërtimin e Rugës “Guri i Matozit-Gradancë” në Mushtisht, Faza I me gjatësi L=2113.0 m.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.07.2025 në ora 15:00 në objektin e Kuvendit Komunal të Suharekës do të organizohet debat publik nga Komuna e Suharekës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë Komuna e Suharekës, për Pëlqim Mjedisor, – për Ndërtimin e Rugës “Guri i Matozit-Gradancë” në Mushtisht, Faza I me gjatësi L=2113.0 m

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “L & D Energy Solutions” shpk Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun e Energjisë Solare – Fotovoltaik 1 MWp, në Petrovë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.07.2025 në ora 11:00 në objektin e SHFMU “Bajram Currri” Petrovë, Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania “L & D Energy Solutions” shpk Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “L & D Energy Solutions” shpk Prizren, për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun e Energjisë Solare – Fotovoltaik 1 MWp, në Petrovë, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. me seli në Gjilan, me pronar Emine Hoti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811497769 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Law Firm Consulting E Hoti” D.O.O. od Gnjlane, sa vlasnikom Emine Hoti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811497769 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Emine Hoti, has come to the decision to quit its business: 811497769 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT
TË SHOQËRISË
" CC Apartments" L.L.C.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit të Shoqërisë, të plotësuara dhe ndryshuara, Kuvendi i Aksionareve të shoqërisë "CC Apartments" L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810168395 ("Shoqëria") ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË
SHOQËRISË me datë 02.06.2025

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga nga vlera e regjistruar
6,891,246.15 Euro në 162,102.00 Euro

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për moszvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"CC Apartments" L.L.C , Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, Fushë Kosove.

**Thirrja për aplikim
(DHËNJE TË OFERTËS)**

“XHEVDET ZYMERI” B.I. me Numer Unik Biz: 812026533 me seli te biznesit në Adresa: **Novolan pn komuna Vushtrri**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim: për kompanit e Interesuara për Ofertim **të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:**

1. Traktor 4x4 me kabine dhe klime,
2. Freze tip vertikal
3. Pllug jo rrotullues
4. Maqine per Mbjellse gruri,
5. Trina tip i rand
6. Energjia Solar

*****Specifikat teknike dhe karakteristika tjera te kerkuara do te dorezohen ne ftesen per kuotim.**

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek **“XHEVDET ZYMERI”B.I. pronar “XHEVDET ZYMERI** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (**5 ditë nga data e publikimit**)

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit të ftesave** për kuotim,

ofertat dorëzohen në Adresën: **Novolan në komunën Vushtrri**
Për Informata Shtesë tel: **+383 45 500 223** dhe në email adresën:

detifarms@gmail.com

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “H.Seferi” sh.p.k. – Gjinoc, Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Bazën e Prodhimit të Betonit, Elementeve të Betonit dhe Thermim, Seperim i Gurit Gëlqeror në Gjinoc të Suharekës (Zgjerim i veprimtarisë për qurin dhe seperimin)

Njoftohet publiku i interesuar se më **datën 28.07.2025**, në ora **10:00**, në **objektin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Migjeni”** – Gjinoc, Suharekë, do të organizohet debat publik nga Kompania “H.Seferi” sh.p.k. – Gjinoc, Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.
<https://us05web.zoom.us/j/2693380475?pwd=ZEpzTUNmaHlTRVn3VXZqRU5kaXRTUT09>

Meeting ID: 269 338 0475

Passcode: BBqP2x

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni **Raportin e VNM-së për Kompaninë “H.Seferi” sh.p.k. – Gjinoc, Suharekë, për Pëlqim Mjedisor – për Bazën e Prodhimit të Betonit, Elementeve të Betonit dhe Thermim, Seperim i Gurit Gëlqeror në Gjinoc të Suharekës:**

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emailin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin:

 vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejter

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905